



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

(projekt)

(Nr. _____ datë _____ 2021)

PËR

MIRATIMIN E KOSTOVE TË PËRLLOGARITURA PËR PYLLËZIM KOMPENSUES NË
RASTET E NDRYSHIMIT TË DESTINACIONIT TË FONDIT PYJOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për pyjet", me propozimin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave;

V E N D O S I :

1. Përcaktimin e kostove të përllogaritura, që subjektet duhet të paguajnë paraprakisht për pyllëzimin kompensues, si rezultat i ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondit pyjor, të lejuara nga ligji.
2. Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë kuptimin:
 - a) "Destinacion" është kategoria/forma e përdorimit të fondit pyjor.
 - b) "Kosto të përllogaritura", janë shuma e shpenzimeve materiale dhe sasitë e punës së gjallë duke përfshirë mirëmbajtjen dhe shërbimet kulturore të nevojshme, për të realizuar pyllëzimin e detyrueshëm të sipërfaqeve pyjore, të cilave u ndryshon destinacioni i përdorimit, në sajë të një aktiviteti të miratuar paraprakisht dhe të lejuar nga ligji për pyjet.
 - c) "Shërbime kulturore", janë shërbime të cilat kryhen në objektet e pyllëzuara artificialisht, të tilla si zëvendësimi i fidanëve të tharë, ujitja, prashitja, plehërimi dhe hijëzimi i fidanëve, për një periudhë kohore jo më pak se 3 vjet, duke përfshirë edhe mbrojtjen e objektit.
 - d) "Rehabilitim", është tërësia e masave që merren, për rigjenerimin dhe kthimin në gjendjen natyrore të njëjtë ose të përafërt me atë të sipërfaqes pyjore të cënuar për shkak të ndryshimit të destinacionit.

3. Sipërfaqet e fondit pyjor, të cilat i nënshtrohen ndryshimit të destinacionit për shkak të një aktiviteti të miratuar mbi to, zëvendësohen dhe/ose kompensohen nëpërmjet rehabilitimit të sipërfaqeve të tjera të fondit pyjor të degraduar. Llogaritja e sipërfaqeve zëvendësuese dhe/ose kompensuese është si vijon:
 - a) e barabartë me 3 (tre) fishin e sipërfaqes që hiqet nga fondi pyjor, për pyjet me formë qeverimi trungishte dhe cungishte.
 - b) e barabartë me sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor, për pyjet me formë qeverimi shkurre, si dhe për sipërfaqet me bimësi pyjore.
4. Kostot e pyllzimeve, kostot e mirëmbajtjes së objekteve të pyllëzuara nëpërmjet shërbimeve kulturele dhe kostot për mbrojtjen e sipërfaqes së pyllëzuar objekt i kompensimit, llogariten mbi bazën e përcaktimit të kostove si më poshtë:
 - a) Kosto e projektuesit;
 - b) Kosto e zbatuesit dhe/ose drejtuesit teknik (mbikëqyrësit të punimeve);
 - c) Kostot e lidhura me punën e gjallë dhe me operacionet e punës gjatë pyllëzimit (përgatitje objekti, hapje gropash, mbjellje, etj);
 - d) Kostot e lidhura me çmimin e fidanëve;
 - e) Kostot e lidhura me skemën e pyllëzimit;
 - f) Kostot e lidhura me shërbimet kulturele për një periudhë jo më pak se 3 vite;
 - g) Kostot për mbrojtjen (ruajtjen) e objektit nga dëmtimet për një periudhë jo më pak se 3 vite.
5. Detajimet për llogaritjen e kostove, skemat e pyllëzimit në funksion të objektit të pyllëzimit dhe të llojit, modelet përkatëse, etj., bëhen në përputhje me udhëzimin e Ministrit, të dalë në zbatim të pikës 5, nenit 5, të ligjit 57/2020 "Për pyjet".
6. Kostot e pyllëzimit kompensues, llogariten nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, në momentin e paraqitjes së kërkesës nga subjekti për fillimin e procedurës të heqjes nga fondi pyjor. Kostot e përlllogaritura i bashkëngjiten raportit teknik-ekonomik të hartuar dhe miratuar nga struktura përgjegjëse për pyjet në bashki dhe i përcillen ministrinë përgjegjëse për pyjet, për vijimin e procedurës për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes, ku do të ushtrohet aktiviteti i lejuar dhe/ose i miratuar. Modelet përkatëse të projekteve të pyllëzimit dhe kostove respektive detajohen në udhëzimin të Ministrit.
7. Pagesa e kostove të përlllogaritura të pyllëzimit kryhet në llogarinë bankare të bashkisë, e cila ka në juridiksionin e saj sipërfaqen pyjore të cënuar dhe pagesa kryhet nga subjekti përfitues, kur ai nuk merr përsipër kryerjen e pyllëzimit kompensues. Në këtë rast pyllëzimi kompensues realizohet nga bashkia dhe/ose subjekti që ka në administrim sipërfaqen.
8. Subjekti kryen pagesën jo më vonë se 10 ditë, nga dita e marrjes dijeni të aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe/ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit, nga autoriteti përgjegjës shtetëror. Bashkia pasi konfirmon pagesën e kryer në llogari të saj, pajis subjektin me një

dokument që vërteton shlyerjen e detyrimit për koston e pyllëzimit kompensues si dhe realizimin e pyllëzimit kompensues nga vetë bashkia. Një kopje e këtij dokumenti i përcillet për dijeni, strukturave përgjegjëse për pyjet në ministrinë përgjegjëse për pyjet.

9. Bashkia dhe/ose subjekti që administron sipërfaqen, brenda 2 (dy) viteve nga data e derdhjes së pagesës në llogarinë e saj, realizon procesin e pyllëzimit sipas projektit të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Pyjeve.
10. Në rast se subjekti merr përsipër të realizojë vetë procesin e pyllëzimit kompensues, 30 ditë pas aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyjor dhe/ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit subjekti lidh marrëveshje me bashkinë dhe/ose subjektin që ka në administrim sipërfaqen, nëpërmjet të cilës angazhohet për realizimin e detyrimit të pyllëzimit kompensues. Pyllëzimi kompensues realizohet nga subjekti për një periudhë jo më vonë se tre vite, nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes dhe pas përfundimit të pyllëzimit, sipas projektit të pyllëzimit dhe kërkesave të marrëveshjes, objekti i pyllëzuar i dorëzohet bashkisë dhe/ose subjektit që administron sipërfaqen.
11. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkitë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi RAMA

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR
MIRATIMIN E KOSTOVE TË PËRLLOGARITURA PËR PYLLËZIM
KOMPENSUES NË RASTET E NDRYSHIMIT TË DESTINACIONIT TË
FONDIT PYJOR”

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektvendimi është që të përcaktojë kostot e përllogaritura, që subjektet duhet të paguajnë paraprakisht për pyllëzimin kompensues, si rezultat i ndryshimit të destinacionit të përdorimit të fondit pyjor, të lejuara nga ligji.

Fondi pyjor kombëtar është objekt i zhvillimit të aktiviteteve të përdorimit, për arsye ekonomike dhe të tjera, të cilat nga njëra anë synojnë ruajtjen, shtimin dhe mos-cënimin e funksioneve të pyllit dhe, nga ana tjetër këto aktivitete ndikojnë në sigurimin e të ardhurave, rritjes së mirëqenies dhe të punësimit.

Fondi pyjor kombëtar është gjithashtu objekt i zhvillimit mbi të, të një sërë aktiviteteve ma natyrë kryesisht ekonomike, të cilat gjatë zhvillimit të tyre ndryshojnë formën e përdorimit dhe për këtë arsye ato i nënshtrohen procedurës së heqjes ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit, për t'u vënë në dispozicion të veprimtarisë së kërkuar.

Diferencat e krijuara mbi fondin pyjor kombëtar si shkak i këtyre veprimtarive, duhet të zëvendësohen, mbështetur kjo në parimin e zëvendësimit dhe të mbrojtjes e shtimit të resurseve natyrore. Si rezultat, ky draft VKM synon të llogaritë kostot që nevojiten për zëvendësimin e sipërfaqeve pyjore nëpërmjet pyllëzimit, të cilat i bëhen me dije dhe i përcaktohen si detyrim ligjor paraprak subjektit që çënon këtë sipërfaqe.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektvendimi janë pikërisht:

- përcaktimi i kostove përkatëse për zëvendësimin e sipërfaqes pyjore e cila humbet (tjetërsohet) në sajë të veprimtarive të miratuara mbi të.
- përcaktimi i rasteve të zëvendësimit të fondit pyjor që humbet (tjetërsohet në sajë të veprimtarive që ushtrohen mbi të.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij dokumenti është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2021, miratuar me VKM-në nr. 1125, datë 30.12.2020, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2021”

Projektvendimi është parashikuar gjithashtu si detyrim ligjor në ligjin 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, si dhe nga Dokumenti i Politikave për Pyjet 2019-2030, miratuar me VKM nr. 814, datë 31.12.2018. Në këtë dokument, janë planifikuar aktivitete dhe hapa të rëndësishëm për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, për të maksimizuar përfitimet dhe për të vendosur e ruajtur ekuilibrat natyrorë mbi të.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Aktivitetet e planifikuara për t’u zhvilluar mbi fondin pyjor, duhet të programohen e standartizohen, më qëllim garantimin e vijueshmërisë, ruajtjen e ekuilibrave natyrorë, mbrojtjen e biodiversitetit dhe shtimin e vlerave ekologjike, në përputhje të plotë me objektivat e planeve të mbarështimit e zhvillimit të tyre.

Projektvendimi, është një akt që synon të përcaktojë kostot respektive për sipërfaqet pyjore që do të zëvendësojnë sipërfaqet që çënohet si shkak i ushtrimit të aktiveve ekonomike mbi to. Kostot u bëhen paraprakisht me dije subjekteve operatore dhe, njëkohësisht i detyrojnë ata ligjërisht për kryerjen e pagesës së tyre dhe/ose aplikimin e drejtpërdrejtë të projektit nga vetë ato. Projektvendimi qartëson mënyrën e llogaritjes së këtyre kostove, administrimit të tyre nga administratorët e fondit pyjor kombëtar, duke i hapur rrugën hartimit të një Udhëzuesi të ri, ku do të përcaktohen rregullat, kërkesat, procedurat dhe dokumentacioni i nevojshëm për llogaritjen e kostove të pyllëzimit zëvendësues. Udhëzuesi në kontekstin e tij, do të orientojë strukturat përgjegjëse të pyjeve pranë Njësive të Qeverisjes Vendore se si të procedojnë për të llogaritur kostot e pyllëzimit zëvendësues, ku duhet të mbështeten, përcaktimin e skemave dhe të kostove të tjera të lidhura. Procedura e llogaritjes së kostove ndiqet nga nga strukturat përgjegjëse të pyjeve pranë Njësive të Qeverisjes Vendore, dhe akti për këtë qëllim legjitimohet nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë, dhe i ngarkohet si obligim ligjor subjektit operator.

...shprehimisin veçan me bashkepunimin nder-institucional midis Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe strukturave të varësisë së saj me Njësitë e Qeverisjes Vendore, të cilat shpesh shkaktojnë vonesa në përgatitjen dhe disponueshmërinë e dokumentacionit përkatës të kërkuar për të vijuar procedurën e heqjes nga fondi pyjor, për shkak të radhës së planifikuar të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Projektvendimi pritet të ketë efekte mjaft pozitive mbi fondin pyjor, duke detyruar subjektet e interesuarqë të zëvendësojnë dhe njëkohësisht të garantojnë vijueshmërinë e fondit pyjor kombëtar dhe të burimeve natyrore në veçanti.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi si akt nënligjor nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 5, të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”. kucitohet shprehimisht: “Subjektet përfituese, për të cilat është miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit pyjor kombëtar, detyrohen të paguajnë paraprakisht kostot e përlllogaritura për pyllëzimin kompensues përkatës, përfshirë kostot e mirëmbajtjes së nevojshme pas mbjelljes që garanton zënien efektive të tyre, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave dhe detajimit me udhëzim të ministrit. Subjektet që ushtrojnë këto aktivitete të lejuara nga ligji, detyrohen për rehabilitimin e sipërfaqes në të cilën është ushtruar aktiviteti përkatës.”.

Projektvendimi është gjithashtu në harmoni dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi vendas dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi është dokument teknik, i dalë në zbatim të legjislacionit kombëtar, konkretisht të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020, dhe nuk synon përafrim të legjislacionit evropian

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT

Projektvendimi është i strukturuar në 12 pika.

- Në pikën e parë përcaktohet synimi i këtij projektvendimi.
- Në pikën e dytë të projektvendimit, jepen përkufizimet dhe bëhet shpjegimi i terminologjisë së përdorur në projektvendim.

... në pikën e trete, përcaktohen rastet se cilat sipërfaqe i nënshtrohen llogaritjes së kostove zëvendësuese.

- Në pikën e katërt përcaktohen sasi të kompensuese për secilin rast kur tjetërsohet sipërfaqja e fondit pyjor kombëtar.
- Në pikën e pestë, përcaktohen aktivitetet që kostohen dhe që sjellin kostot totale të llogaritura për sipërfaqet zëvendësuese.
- Në pikën e gjashtë i hapet rruga hartimit të një udhëzuesi të posaçëm që standartizon procedurën e llogaritjes së kostove.
- Në pikën e shtatë përcaktohet se kush i llogarit kostot kompensuese dhe detajet i referohen sërish në udhëzimin e sipërcituar.
- Në pikën e tetë përcaktohet se për cilin subjekt kryhen pagesat e kostove kompensuese në rastin kur operatori nuk e kryen vetë detyrimin kompensues, ndërsa në pikën e nëntë përcaktohen afatet dhe modalitetet e komunikimit ndërmjet institucioneve administruese të sipërfaqes pyjore dhe operatorit, në rastin kur ky i fundit e merr përsipër ta zbatojë vetë projektin për zëvendësimin e sipërfaqes pyjore.
- Në pikat dhjetë dhe njëmbëdhjetë, jepen afatet kohore të zbatimit konkret të projekteve të pyllëzimit, respektivisht për bashkinë dhe subjektet administruese të fondit pyjor dhe për operatorët në rastin kur këta të fundit marrin përsipër realizimin e investimit kompensues.
- Në pikën dymbëdhjetë, përcaktohen institucionet të cilat ngarkohen për zbatimin e këtij projektvendimi .

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen Bashkitë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe është konsultuar me të gjitha strukturat e vartësisë të ministrisë.

Ky projektvendim do t'i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i projektvendimit nuk ka kosto mbi buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe për rrjedhojë as në buxhetin e shtetit.

MINISTRI
BLENDI KLOSI